

VENDIM
Nr.721, datë 20.10.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.902, DATË 19.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN BRADASHESH, TË QARKUT TË ELBASANIT” DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.403, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA BRADASHESH, TË QARKUT TË ELBASANIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesave dhe pakësimeve në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, pyje dhe kullota, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Bradashesh të qarkut të Elbasanit, që i bashkëlidhet vendimin nr.902, datë 19.2.2007 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht si vijon:

a) Lista shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë dhe fillon me numër prone 1909 e mbaron me numër 1915.

b) Lista pakësuese, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë me numrat e pronave 727 dhe 776.

2. Miratimin e shtesave dhe pakësimeve në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bradashesh të qarkut të Elbasanit, që do t’i transferohen në përdorim kësaj njësie, që i bashkëlidhet vendimit nr.403, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave, përkatësisht si vijon.

a) Lista shtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 3 (tri) fletë dhe mbaron me numër rendor 78.

b) Lista pakësuese, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është me 1 (një) fletë dhe mbaron me numër rendor 1.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bradashesh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha